



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:154092

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06522908

Rev.nr.526/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Muhamet Rexha, anëtar, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit-të kundër paditurit L.D. nga L. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Qëndrim Reqica av. nga L., kundër të paditurve-kundër paditësve Xh. I. dhe Sh. I. nga fshati T., Komuna e L., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Valon Sadiku av. nga L., me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, përkitazi me revizionin e të paditurve -kundër paditësve, të paraqitur përmes të autorizuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4184/2022, datë 19.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.11. 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuar revizioni i të paditurve-kundër paditësve Xh. I. dhe Sh. I. nga fshati T., Komuna e L., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4184/2022, datë 19.09.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.206/2018, datë 08.02.2022, ishte vendosur " I.APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit-të kundër paditurit L. D. nga L. si e bazuar dhe DETYROHEN të paditurit-kundër paditësit Xh. I. dhe Sh. I. nga fsh.T. K. L., që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, për dëmin e shkaktuar në incidentin e dt. 22.08.2016, paditësit-të kundër paditurit L. D. nga L. t'ia paguajnë shumat si vijon: I/a.në emër të dëmit jomaterial

- Për dhimbje fizike shumë prej.....1.200-€;

- Për frikën e pësuar shumën prej.....1.000-€;
- I/b. Në emër të dëmit material
- Në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit të huaj.....118.86 -€;
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....136.50 -€;
- Në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej..... 314.70-€

Këto me kamatë ligjore prej 8% e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri te pagesa definitive.

II.DETYROHEN të paditurit-kundër paditësit Xh. I. dhe Sh. I. nga fsh.T. K. L., që shumën e përgjithshme në lartësi prej 2770.06-€ dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 718.40-€ në mënyrë solidare t'ia kompensojnë paditësit-të kundër paditurit L. D. nga L., të gjitha në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkespadiisë së paditësit-kundër paditurit përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën I/a, I/b, të dispozitivit të këtij aktgjykimi si e pabazuarë, dhe atë për dhimbje fizike shumën prej 4.500-€, për frikën e pësuar shumën prej 4.000-€, në emër të ndihmës dhe përkujdesit nga personi tjetër shumën prej 300-€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 450-€, si e pabazuar.

IV.REFUZOHET në tërësi, kundër padia e të paditurve-kundër paditësve Xh. I. dhe Sh. I. nga fsh.T. K. L., me të cilën kanë kërkuar që të Vërtetohet se paditësi-i kundër padituri L. D. me datë 22.08.2016 i ka shkaktuar dëm material dhe jomaterial të paditurve-kundër paditësve dhe të Obligohet paditësi-kundër padituri L. D. që t'ia kompensojë dëmin matreial dhe jomaterial nga lëndimi që kanë pësuar dhe atë secilit veç e veç:

1.Xh. I. II/a.në emër të dëmit jomaterial

- Për dhimbje fizike shumën prej.....2.000-€;
- për frikën e pësuar shumën prej.....1.800-€;

II/b. Në emër të dëmit material

- Në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit të huaj.....250.00 -€;
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....200.00. -€;

- Në emër të rehabilitimit klimatik shumën prej150.00-€
- 2.Sh. I. II/a.në emër të dëmit jomaterial
- Për dhimbje fizike shumën prej.....2.000-€;
 - për frikën e pësuar shumën prej.....2.500-€;
- II/b. Në emër të dëmit material
- Në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit të huaj.....250.00 -€;
 - Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....200.00. -€;
 - Në emër të rehabilitimit klimatik shumën prej150.00-€,

Të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % nga data 22.08.2016 si datë e shkaktimit të dëmit e deri te pagesa definitive, si e PABAZUAR".

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4184/2022, datë 19.09.2024, ishte vendosur " I.REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurve-kundër paditësve Xh. I. dhe Sh. I. nga fshati T., Komuna e L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, C.nr.206/18 i datës 08.02.2022, në pikën I, II dhe IV të dispozitivit vërtetohet. II. Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar mbetet e pashqyrtuar. "

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, Ac.nr.4184/2022, datë 19.09.2024, të paditurit – kundër paditësit Xh. I. dhe Sh. I. nga fshati T., Komuna e L. përmes të autorizuarit avokat Shpetim Sadiku nga L., kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë në pjesën e refuzimit të kërkesëpadisë së të paditurve – kundër paditësve, të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia ose të prishen të dy aktgjykimet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësit- të kundër paditurit, nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditurit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i të paditurve- kundër paditësve, është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka paraqitur padi në gjykatë më dt. 16.05.2018, kundër të paditurve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e sulmit nga paditësi me datë 22.08.2016. I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadsisë dhe precizimit të saj, thekson se më datë 22.08.2016, brenda objektit të KEDS në L., është penguar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ku me këtë rast paditësi është sulmuar fizikisht nga të paditurit duke pasuar kështu lëndime trupore dhe rasti ka ndodhur gjatë orarit të punës, përkatësisht në zyrën e paditësit duke e fyer dhe sulmuar fizikisht, si pasojë e përdorimit të forcës përkatësisht sulmit janë shkaktuar lëndime të lehta trupore paditësit nga të paditurit gjë që për të cilën të paditurit janë gjykuar për veprën e tyre përmes aktgjyqimit penal P.nr.860/17 i datës 22.01.2018, i plotfuqishëm me dt. 14.02.2018.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit-kunderpaditësit dhe precizimit të saj si dhe duke vepruar sipas kundërpadsisë së të paditurve-kunderpaditësit të paditurve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.206/18, të datës 08.02.2022, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit-kundër paditësit, dhe duke e refuzuar në tërësi kundërpadinë e të paditurve duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyqimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë, mirëpo e njëjta u vërtetua në bazë të aktgjyqimit të plotfuqishëm penal të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan i cili evidentohet me shenjën P.nr.860/17 të dt.22.01.2018, ku të paditurit-kundër paditësit Xh. I. dhe Sh. I. në procedurën penale janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën.par. 1.4 të KPRK-së, për shkak se me dt.22.08.2016 rreth orës 14:15, në objektin e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS sh.a në L., të pandehurit -kundër paditësit Xh. dhe Sh. I. secili veç e veç me dashje e sulmojnë fizikisht të dëmtuarin L. D., punëtor i Kompanisë KEDS, në atë mënyrë që të pandehurit kishin shkuar te zyrat e KEDS-it me qëllim të ndërrimit të pronarit të njehsorit elektrik dhe pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin lidhur me zbatimin e procedurave të tilla, shprehin pakënaqësi për çka fillimisht me fjalë e ofendime e pastaj e shtynjë me forcë për muri të jashtëm të këtij objekti, ashtu që e sulmojnë edhe fizikisht me grushta dorë në kokë, ndërkaq në vetëmbrojtje i dëmtuari po ashtu ju kundërpërgjigjet me grushte dore në kokë, me ç'rast i dëmtuari dhe të pandehurit, sipas ekspertizës mjeko-ligjore, i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjeve fizike për paditësin-kundër të paditurin L. D. aprovoi kërkesën në shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, ndërsa refuzoi në tërësi kërkespadinë e të paditurve – kundër paditësve si të pa bazuar. Në gjendjen faktike të vërtetuar kësaj gjykata ka gjetur se të paditurit nga baza e përgjegjësisë në bazë të fajit të shkaktuar me vepër penale janë përgjegjës për kompensimin e dëmit, ngase të njëjtit me veprimet e tyre të kundërligjshme i kanë shkaktuar lëndime trupore paditësit, duke u shpallur penalisht përgjegjës me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor, dhe mbi bazën e mendimit dhe konstatimit mjekësor të lartpërmendur, të vlerësimit të lirë, dhe të vlerësimit edhe të faktorëve tjerë relevant për caktimin e lartësisë së dëmshpërblimit, ka gjykuar në favor të paditësit dëmshpërblimin, në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se rrjedh detyrimi ligjor i të paditurve-kundër paditësve, që paditësit-të kundërpaditurit, t'ia kompenzojnë dëmin e shkaktuar, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërkaq kundër paditësit-të paditurit në rastin konkret nuk kanë bazë ligjore për kompensim. Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar edhe të drejtën materiale kur është bazuar në dispozitat 136 par. 1 të LMD-së e shpjegon mjaft qartë përgjegjësinë e personave fizikë me rastin e shkaktimit të dëmit, ku citohet "Kush i shkakton tjetrit dëm ka për obligim që ta kompenzojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij" Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi, pasi që ka rezultuar se nuk ka pasur pretendime ankimore nga palët paditëse për pikën III, në ndërkohë që kjo pjesë e aktgjykimit është në favor të palës së paditur, për çka edhe kjo pjesë të dispozitivit të aktgjykimit ka mbetur e pashqyrtuar.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës, për pjesën aprovuese, pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të parë, lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave, në këtë pjesë nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e lartcekura në këtë pjesë nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë, ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, kur ka refuzuar ankesën e të paditurve – kundër paditësve dhe ka vërtetuar r aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket refuzimit të pjesës së kërkesëpadisë së kundër paditësve. Duke pasur parasysh këto kritere të parapara me dispozitat e lartcekura, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë

përkitazi me llojet e dëmit jo material, sipas vlerësimit të kësaj gjykate ishin reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore si dhe në harmoni me praktikën gjyqësore të deritashme të gjykimit të dëmshpërblimit në raste të ngjashme.

Duke u nisur nga fakti se revizioni lidhet vetëm me pjesës refuzuese të kundërpadisë së kundër paditësve-të paditurve, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson se qëndrimi i gjykatave të instancës më të ulët është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është zbatuar drejtë ligji material kur u refuzua si tërësisht të pabazuar sepse rezulton se kundër paditësit (në këtë rast të paditurit) me veprimet e tyre të kundërligjshme i kanë shkaktuar dëm, respektivisht lëndime të lehta trupore të dëmtuarit (këtu paditësit) L. D., për çka edhe nga këto veprime të shkaktuara të kundërligjshme, të njëjtit janë shpallur fajtor me aktgjykimin e plotfuqishëm penal P.nr.1860/17 të dt.14.12.2018, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, duke u dënuar me dënim me gjobë secili nga 300-€, ndërsa i dëmtuari (në këtë rast paditësi) për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Pretendimet se me këtë rast të paditurit kanë pësuar lëndime dhe se paditësi – i kundër padituri duhet t'ua kompensoi nuk janë të bazuara në ligj, duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësinë në bazë të fajit, lëndimet e lehta trupore të pësuar të kundër paditësve nuk paraqesin bazë ligjore për kompensimin e dëmit, ngase dispozita ligjore e nenit 136 par 1 të LMD-së e shpjegon mjaft qartë përgjegjësinë e personave fizikë me rastin e shkaktimit të dëmit, ku citohet “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për obligim që ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në një proces penal është konstatuar se parashtruesit e revizionit janë fajtor dhe janë dënuar për lëndimet trupore të shkaktuara paditësit – të kundër paditurit në vendin e punës, dhe përtej kësaj bazuar në nenin 14 të LPK-së ku parashihet se " Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor."

Prandaj edhe kjo gjykatë konsideron se të paditurit kundër paditësit nuk kanë bazë ligjore për të kërkuar kompensimin e dëmeve në rastin konkret dhe Gjykata Supreme e aprovon në tërësi qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët.

Për shkak se me aktgjykimin e atakuar si dhe atë të shkallës së parë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë është aplikuar e drejta materiale dhe me pretendimet e revizionit nuk vihet në pyetje ligjshmëria e aktgjykimeve të atakuar, revizioni i të paditurve – kundër paditësve, u refuzua si i pa bazuar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion, nuk janë vlerësuar, pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222, dhe 224.1, të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.526/2024, datë 27.11.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami